



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
LIPJAN



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF

Nr: 03-111/01-11174
Datë: 05.03.2026

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
Shtëpia me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuar-ngecje në zhvillim mendor

Bazuar në nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Rregullore (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimë të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të punës

Nji (1) Udhëheqës/e në Shtëpinë me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuar-ngecje në zhvillim mendor.

Detyrat e Punës

1. Mbështet dhe ofron këshilla për drejtorin e Departamentit dhe sipas kërkesës për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit dhe titullarin e institucionit për fushën e përgjegjësisë së Divizionit që udhëheqë.
2. Drejton dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e Divizionit dhe siguron funksionim efikas të tij, si dhe ndihmon Drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave.
3. Kontribuon në procesin e vendimmarrjes sipas fushës së përgjegjësisë, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analizave të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes.
4. Planifikon, përgatit, monitoron dhe analizon buxhetin e Divizionit si dhe aktivitetet tjera të Divizionit dhe siguron përmbushjen e tyre sipas planit.
5. Organizon dhe shpërndan punën për stafin të tij dhe menaxhon realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësitë e Divizionit.
6. Udhëzon stafin në përmbushjen e aktiviteteve të përditshme dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse.
7. Me autorizimin e mbikëqyrësit, përfaqëson institucionin në takime pune, konferenca në fushën e përgjegjësisë së Divizionit të cilin e udhëheqë.
8. Siguron komunikimin brenda dhe jashtë njësive organizative dhe institucionit me qëllim të mbledhjes ose shkëmbimit të informacionit.
9. Bën vlerësimin e rezultateve të punës për stafin nën mbikëqyrje të tij/saj dhe identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

Kushtet dhe kriteret:

- Fakulteti Baçelor i Shkencave në Infërmieri – Drejtimi i Përgjithshëm.
- Vërtetimi i provës së punës.
- Certifikata Shëndetësore (jo ma e vjetër se gjashtë muaj)
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan (jo ma vjetër se gjashtë muaj)
- Kopja e Letërnjoftimi (me afat).

Aftësitë:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur dhe në grupe duke respektuar ligjet si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë
- Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim: moshe, gjinie, kulture, etnike apo religjioni.

Paga mujore:

Grupi GJ klasa GJ4 Koeficienti:8.24

Kohëzgjatja e kontratës me kohë të caktuar (mandat 4 vjeçar)

Puna Provuese gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data 05.03/2026 deri 03.04/2026 që konsiderohet si dita e fundit e konkurrimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mund të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Kandidatet të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës duhet që diploma e tyre të jetë e njohur(nostifikuar) nga Ministria e Arsimit Shkences dhe Teknologjisë.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje,(të noterizuara Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në ueb faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/Lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

